

TABELAT E BURIM-PËRDORIMEVE

2024

INSTAT publikon tabelat e konsoliduara të Burim-Përdorimeve (TBP), për vitin 2024, të cilat ofrojnë një pamje të detajuar të ekonomisë. Ato janë një instrument i rëndësishëm në analizën dhe krijimin e modeleve statistikore. Këto tabela përshkruajnë; burimet dhe përdorimet e produkteve, si dhe lidhjet ndërdegësore në ekonomi.

Burimet dhe Përdorimet gjithsej me çmime korrente në vitin 2024, u vlerësuan respektivisht 5,103,229 milion lekë, duke shënuar një rritje në terma nominalë, prej 4,92% krahasuar me vitin 2023.

- Prodhimi përfaqëson 72,1% të burimeve gjithsej me çmime korrente, ku të mirat materiale zënë 46.0%, ndërsa shërbimet 54,0%. Importi përfaqëson 21,3% të burimeve gjithsej, ku të mirat materiale të importuara përbëjnë 66,8 % ndërsa shërbimet 33,2%;
- Konsumi ndërmjetës përfaqëson 29,4% të përdorimeve gjithsej me çmime korrente, ku të mirat materiale zënë 74,8% ndërsa shërbimet 25.2%;
- Kërkesa finale përfaqëson 70,6% të përdorimeve gjithsej, ku kërkesa për të mira materiale zë 57.1% dhe për shërbime 42,9%.

TAB. 1 TABELA E BURIMEVE DHE PËRDORIMEVE ME ÇMIME KORRENTE PËR VITIN 2024, NË MILION LEKË

Aktivitetet (NVE)	Të mira materiale	Shërbime	Prodhimi gjithsej sipas produkteve	Importet (CIF)	MTT*	Burime gjithsej	Të mira materiale	Shërbime	Konsumi ndërmjetës sipas produkteve	Kërkesa Finale	Përdorime gjithsej
Produkte (NP)	1	2	3=1+2	4	5	6=3+4+5	7	8	9=7+8	10	11=9+10
Të mira materiale [01-43]	1,676,087	15,180	1,691,268	726,489	762,189	3,179,946	698,598	422,727	1,121,325	2,058,620	3,179,946
Shërbime [45-98]	71,309	1,916,136	1,987,445	360,448	(424,610)	1,923,283	76,670	301,016	377,686	1,545,597	1,923,283
Gjithsej	1,747,396	1,931,317	3,678,713	1,086,937	337,579	5,103,229	775,269	723,743	1,499,012	3,604,217	5,103,229
Vlera e shtuar							972,127	1,207,574	2,179,701		

* Marzhet e tregtisë, transportit dhe taksat neto mbi produktet

Tabela e Burimeve

Kjo tabelë ofron një vlerësim për burimet e të mirave materiale dhe shërbimeve të prodhuara në vend dhe atyre të importuara. Sipas rreshtave paraqiten burimet e produkteve, ndërsa sipas kolonave aktivitetet ekonomike që i përdorin këto produkte. Klasifikimi i çdo njësie ekonomike bazohet në produktin që zë pjesën më të madhe të prodhimit të saj.

TAB. 2 TABELA E BURIMEVE ME ÇMIME BAZË DHE TRANSFORMIMI ME ÇMIME KORRENTE, NË MILION LEKË

Aktivite	A	B-E	F	G-I	J	K	L	M-N	O-Q	R-U	Prodhimi sipas produkteve	Importet (CIF)	MTTT**	Burimet gjithsej
Produkte (NP) *	Output of industries (NACE). at basic prices													
A	419,199	264	-	677	-	-	-	116	37	-	420,292	27,542	83,117	530,951
B-E	95,764	586,506	5,778	4,097	29	-	17	1,276	204	913	694,584	698,739	656,492	2,049,815
F	-	4,639	563,937	5,292	-	-	147	1,137	195	1,044	576,392	208	22,579	599,179
G-I	29,991	12,192	13,502	787,124	115	-	1,590	4,706	1,366	4,971	855,558	213,644	(437,623)	631,579
J	-	258	535	240	154,456	-	-	501	-	36	156,026	21,489	6,852	184,367
K	-	-	-	332	-	85,382	593	757	-	-	87,065	12,393	823	100,281
L	-	652	12,785	1,351	110	-	134,565	276	307	29	150,076	-	332	150,408
M-N	-	392	412	5,401	773	-	27	276,890	195	1,799	285,891	47,374	4,077	337,342
O-Q	-	262	8	223	-	-	74	77	384,935	1,192	386,770	8,569	256	395,596
R-U	-	208	112	398	14	-	154	777	427	63,970	66,060	56,978	673	123,711
Prodhimi sipas aktiviteteve	544,954	605,373	597,069	805,134	155,497	85,382	137,169	286,514	387,666	73,956	3,678,713	1,086,937	337,579	5,103,229
PT***	437,792	562,424	534,754	793,032	136,828	81,811	26,443	279,221	93,063	54,818	3,000,185			
PPP****	107,093	23,778	55,642	4,030	15,852	6	110,565	2,193	3,926	110	323,195			
PJT*****	70	19,171	6,673	8,072	2,816	3,565	161	5,100	290,677	19,027	355,332			

* Grupimi i aktiviteteve dhe produkteve bazuar në Nomenklaturën e Veprimtarive Ekonomike (NVE Rev.2) dhe Nomenklaturën e Produkteve (NP 2008)

** Marzhet e tregtisë, transportit dhe taksat neto mbi produktet

*** Prodhimi tregtar


**** Prodhimi për përdorim përfundimtar vetjak

***** Prodhime të tjera jo të tregut

Komponentët e tabelës së burimeve për vitin 2024, krahasuar me vitin 2023, paraqiten si më poshtë:


- Prodhimi vendas, i cili përbën peshën kryesore të tabelës së burimeve ka shënuar ulje me 0,3%;
- Importet e të mirave materiale dhe shërbimeve kanë shënuar ulje me 0,1%;
- Taksat neto mbi produktet kanë shënuar rritje me 0,3%.

FIG. 1 STRUKTURA E BURIMEVE, NË %



Për sa i përket strukturës së tabelës së burimeve sipas origjinës (Fig.2) me çmime bazë, prodhimi vendas zë 77.2 % të burimeve, ndërsa importet zënë 22.8%.

FIG. 2 STRUKTURA E BURIMEVE ME ÇMIME BAZË, SIPAS ORIGINËS SË PRODUKTEVE, NË %



Në vitin 2024, peshën më të madhe në strukturën e prodhimit me çmime bazë e zënë produktet e prodhuara nga aktivitetet Tregtia, Transporti, Akomodimi dhe shërbimit ushqimor me 23,3%; Industria me 18,9% dhe Ndërtimi me 15,7%. Në strukturën e produkteve të importuara, peshën më të madhe e zënë produktet e Industrisë me 64,3%, ndjekur nga Tregtia, Transporti, Akomodimi dhe Shërbimit Ushqimor me 19,7%.

TAB.3 STRUKTURA E BURIMEVE, SIPAS ORIGINËS SË PRODUKTEVE, 2024

Produktet (NP)		Prodhimi		Importe	
		mln	%	mln	%
A	Bujqësia, pyjet dhe peshkimi [1-3]	420,292	11,4%	27,542	2,5%
B-E	Industria gjithsej [5-39]	694,584	18,9%	698,739	64,3%
F	Ndërtimi [41-43]	576,392	15,7%	208	0,0%
G-I	Tregtia, Transporti, Akomodimi dhe shërbimit ushqimor [45-56]	855,558	23,3%	213,644	19,7%
J	Informacioni dhe komunikacioni [58-63]	156,026	4,2%	21,489	2,0%
K	Shërbime financiare dhe të sigurimit [64-66]	87,065	2,4%	12,393	1,1%
L	Shërbime të pasurive të paluajtshme [68]	150,076	4,1%	-	0,0%
M-N	Shërbime shkencore, Profesionale , Administrative, Mbështetëse [69-82]	285,891	7,8%	47,374	4,4%
O-Q	Administrata publike, Arsimi, Shëndetësia, Aktivitete të punës sociale [84-88]	386,770	10,5%	8,569	0,8%
R-U	Arte, Argëtim dhe çlodhje, Aktivitete të tjera shërbimi [90-98]	66,060	1,8%	56,978	5,2%
Burimet gjithsej me çmime bazë		3,678,713	100,0%	1,086,937	100,0%

Tabela e Përdorimeve

Në tabelën e përdorimeve paraqiten drejtimet kryesore të përdorimit të burimeve në ekonominë e vendit. Ato paraqiten në formën e përdorimit si: Konsum Ndërmjetës, Konsum Final i Familjeve, Konsum Final i Administratës Publike, Formimi Bruto i Kapitalit dhe Eksporte. Kjo tabelë paraqet në kolona strukturën e inputeve për çdo degë të aktivitetit ekonomik dhe në rreshta përdorimin e të mirave materiale dhe shërbimeve të disponueshme.

Komponentët e tabelës së Përdorimeve për vitin 2024, krahasuar me vitin 2023 paraqiten si më poshtë:

- Konsumi final, i cili përbën peshën kryesore të shpenzimeve në ekonomi ka shënuar rritje me 4,9%;
- Konsumi Ndërmjetës ka shënuar rritje me 2,8%;
- Komponenti i Formimit bruto të kapitalit ka shënuar rritje me 15,4%;
- Eksportet e të mirave materiale dhe shërbimeve kanë shënuar rritje me 1,8%.

TAB. 4 TABELA E PËRDORIMEVE ME ÇMIME KORRENTE, NË MILION LEKË

Aktivite (NVE)	A	B-E	F	G-I	J	K	L	M-N	O-Q	R-U	KN* sipas produkteve	SHKF**	FBKF***	Eksporte(FOB)	Përdorime çmime korrente
Produkte (NP)	Konsumi ndërmjetës i industrive (NVE)											P3_S13-14	P51-52	P6	
A	123,141	30,861	3,615	23,761	142	41	207	853	16	113	182,750	321,795	348	26,058	530,951
B-E	34,950	244,864	202,684	200,992	51,415	6,348	2,559	56,348	42,292	12,679	855,131	844,026	150,291	200,367	2,049,815
F	303	11,532	46,648	6,063	1,590	6	1,292	7,022	8,595	393	83,443	40,370	473,545	1,820	599,179
G-I	360	8,200	2,176	35,859	4,128	2,782	61	16,853	6,498	1,225	78,143	185,187	-	368,249	631,579
J	3	3,493	1,122	4,771	21,960	7,999	340	6,411	656	1,642	48,397	42,383	18,451	75,135	184,367
K	351	8,172	4,567	14,452	460	8,197	289	909	1,832	1,888	41,117	22,943	-	36,221	100,281
L	58	8,781	2,530	7,966	2,139	5,392	4,482	4,589	1,264	2,469	39,670	110,738	-	-	150,408
M-N	440	9,570	26,020	33,109	12,462	14,665	608	19,228	11,980	3,424	131,504	61,043	33	144,761	337,342
O-Q	1	403	151	387	9	154	0	691	28,978	788	31,562	349,927	-	14,107	395,596
R-U	1	247	24	2,266	69	140	2	39	76	4,431	7,293	69,538	11	46,869	123,711
KN sipas aktiviteteve	159,608	326,123	289,538	329,626	94,374	45,724	9,840	112,943	102,186	29,052	1,499,012	2,047,949	642,680	913,587	5,103,229
Vlera e Shtuar	385,346	279,250	307,532	475,508	61,123	39,658	127,329	173,571	285,480	44,904	2,179,701				

* Konsumi ndërmjetës

**Konsumi Final i Familjeve dhe Administratës Publike

*** Formimi Bruto i Kapitalit Fiks dhe Ndryshimi i Gjendjeve


**** Kompensimi i punonjësve përveç pagave

***** Taksat e tjera minus subvencionet e tjera mbi prodhimin

***** Fritimi Operativ Bruto


Gjatë vitit 2024, struktura e tabelës së përdorimit të të mirave materiale dhe shërbimeve të disponueshme nga përdoruesit brenda dhe jashtë territorit të vendit (Fig.3), paraqitet e tillë: 29,4% është përdorur për konsum ndërmjetës në proceset e prodhimit; 40,01% është përdorur për konsum final nga familjet dhe administrata publike; 12,6% është përdorur për formim bruto të kapitalit dhe 17,9% është eksportuar.

FIG. 3 STRUKTURA E TABELËS SË PËRDORIMEVE, NË %



Në tabelën e përdorimeve (Fig.4), të mirat materiale përfaqësojnë 62,3% të përdorimeve gjithsej, ndërsa shërbimet 37,7%. Përdorimi i të mirave materiale zë peshën kryesore në konsumin ndërmjetës me 74,8% dhe në formimin bruto të kapitalit me 58,9%.

FIG. 4 STRUKTURA E PËRDORIMEVE SIPAS KOMPONENTËVE, NË %



Në vitin 2024, peshën më të madhe në strukturën e përdorimeve të brendëshme me çmime tregu (ku përfshihet konsumi ndërmjetës, konsum final i familjeve dhe administratës publike, formim bruto të kapitalit fiks dhe ndryshim gjendje), e zënë produktet e Industrisë me 44,1%, pasuar nga Ndërtimi me 14,3% dhe Bujqësia, pyjet dhe peshkimi me 12,1%.

Në strukturën e produkteve të eksportuara në 2024, peshën më të madhe e zënë produktet e Transporti, Akomodimi dhe shërbimit ushqimor me 40,3%, ndjekur nga Industria me 21,9%.

TAB. 5 STRUKTURA E PËRDORIMEVE SIPAS DESTINACIONIT

Produktet (NP)		Përdorim i brëndshëm		Eksport	
		mln	%	mln	%
A	Bujqësia, pyjet dhe peshkimi [1-3]	504,893	12.05%	26,058	2.85%
B-E	Industria gjithsej [5-39]	1,849,448	44.14%	200,367	21.93%
F	Ndërtimi [41-43]	597,359	14.26%	1,820	0.20%
G-I	Tregtia, Transporti, Akomodimi dhe shërbimit ushqimor [45-56]	263,330	6.29%	368,249	40.31%
J	Informacioni dhe komunikacioni [58-63]	109,232	2.61%	75,135	8.22%
K	Shërbime financiare dhe të sigurimit [64-66]	64,060	1.53%	36,221	3.96%
L	Shërbime të pasurive të paluajtshme [68]	150,408	3.59%	0	0.00%
M-N	Shërbime shkencore, Profesionale, Administrative, Mbështetëse [69-82]	192,581	4.60%	144,761	15.85%
O-Q	Administrata publike, Arsimi, Shëndetësia, Aktivitete të punës sociale [84-88]	381,488	9.11%	14,107	1.54%
R-U	Arte, Argëtim dhe çlodhje, Aktivitete të tjera shërbimi [90-98]	76,842	1.83%	46,869	5.13%
Burimet gjithsej me çmime bazë		4,189,641	100%	913,587	100%

TAB. 6 TABELA E BURIMEVE ME ÇMIME BAZË DHE TRANSFORMIMI ME ÇMIMET E BLERËSIT (ÇMIME KONSTANTE), NË MILION LEKË

Aktivite (NVE) *	A	B-E	F	G-I	J	K	L	M-N	O-Q	R-U	Prodhimi sipas produkteve	Importet (CIF)	MTTT**	Burimet gjithsej CP***
Produkte (NP) *	Prodhimi sipas aktiviteteve (NVE), me çmime bazë													
A	416,337	263	-	676	-	-	-	115	36	-	417,427	27,398	78,856	523,680
B-E	88,618	576,973	5,392	3,888	34	-	17	1,389	219	919	677,450	664,484	616,262	1,958,197
F	-	4,540	551,875	5,178	-	-	144	1,113	191	1,022	564,063	199	22,862	587,124
G-I	29,491	11,726	13,009	761,765	109	-	1,522	4,493	1,298	4,714	828,126	202,241	(399,325)	631,043
J	-	262	511	231	152,547	-	-	486	-	35	154,073	20,985	6,972	182,029
K	-	-	-	325	-	84,081	580	741	-	-	85,727	11,900	881	98,508
L	-	628	12,311	1,301	106	-	129,982	266	296	28	144,917	-	544	145,462
M-N	-	406	394	5,290	786	-	28	273,745	198	1,719	282,566	46,325	9,238	338,129
O-Q	-	258	8	218	-	-	73	75	373,436	1,170	375,239	8,343	276	383,858
R-U	-	205	114	394	14	-	154	773	423	64,152	66,230	54,336	2,915	123,480
Prodhimi sipas aktiviteteve	534,445	595,261	583,613	779,266	153,596	84,081	132,500	283,197	376,097	73,760	3,595,817	1,036,211	339,481	4,971,509

* Grupimi i aktiviteteve dhe produkteve bazuar në Nomenklaturën e Veprimtarive Ekonomike (NVE Rev.2) dhe Nomenklaturën e Produkteve (NP 2008)

** Marzhet e tregtisë, transportit dhe taksat neto mbi produktet

*** Çmime Konstante

TAB. 7 TABELA E PËRDORIMEVE ME ÇMIME BAZË DHE TRANSFORMIMI ME ÇMIMET E BLERËSIT(ÇMIME KONSTANTE), NË MILION LEKË

Aktivitetet (NVE)	A	B-E	F	G-I	J	K	L	M-N	O-Q	R-U	KN* sipas produkteve	SHKF**	FBKF***	Eksporte(FOB)	Përdorime me çmime konstante
Produkte (NP)	Konsumi ndërmjetës i industrive (NVE)											P3_S13-14	P51-52	P6	
A	122,971	31,000	3,677	23,777	134	38	198	847	15	110	182,767	315,817	427	24,669	523,680
B-E	33,685	238,923	193,629	192,530	50,474	5,909	2,395	53,689	40,285	12,180	823,701	801,488	139,311	193,697	1,958,197
F	295	12,174	47,672	5,884	1,501	6	1,218	6,489	7,981	368	83,587	37,907	463,885	1,745	587,124
G-I	470	9,887	2,756	38,576	4,190	2,937	72	18,125	8,063	1,350	86,425	200,526	-	344,091	631,043
J	3	3,460	1,183	4,840	21,008	7,823	336	6,268	663	1,620	47,203	41,112	20,716	72,998	182,029
K	352	8,115	4,717	14,466	442	7,578	282	867	1,737	1,826	40,383	23,065	-	35,060	98,508
L	58	8,342	2,621	8,003	2,034	5,058	4,346	4,353	1,204	2,398	38,418	107,044	-	-	145,462
M-N	404	9,382	28,148	33,384	13,224	15,090	693	19,597	11,737	3,580	135,240	63,539	33	139,317	338,129
O-Q	1	406	160	376	8	145	0	661	27,033	746	29,536	340,817	-	13,504	383,858
R-U	1	257	27	2,415	71	138	2	37	77	4,545	7,569	71,154	12	44,744	123,479
KN sipas aktiviteteve	158,241	321,945	284,590	324,252	93,087	44,723	9,543	110,932	98,795	28,721	1,474,829	2,002,469	624,385	869,825	4,971,509
Vlera e Shtuar	376,204	273,316	299,023	455,014	60,509	39,358	122,958	172,265	277,302	45,039	2,120,988				

* Konsumi ndërmjetës

**Konsumi Final i Familjeve dhe Administratës Publike

*** Formimi Bruto i Kapitalit Fiks dhe Ndryshimi i Gjendjeve

Burimet dhe Përdorimet gjithsej me çmime konstantë në vitin 2024, u vlerësuan ALL 4,971,509 milion lekë, duke shënuar një rritje në terma realë, prej 2,2% krahasuar me vitin 2023.

Shënim për përdoruesit:

Të dhënat e detajuara mujore dhe vjetore sipas grupeve janë të disponueshme në databazën statistikore të INSTAT:

[Tabelat e Burim Përdorimeve](#)

Metodologjia

Klasifikime

Llogaritjet e TBP-ve mbështeten metodologjikisht në konceptet bazë të Sistemit Evropian të Llogarive (ESA 2010) dhe të Sistemit të Llogarive Kombëtare (SNA 2008) të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB). Ndërtimi i TBP-ve kërkon një numër i madh të dhënash në një nivel shumë të detajuar. Për më tepër lidhur me metodologjinë e përpilimit të TBP, referojuni linkut më poshtë:

<http://www.instat.gov.al/al/publications/librat/2015/tabela-e-burim-p%C3%ABrdorimeve,-2009-2011.aspx>

http://www.instat.gov.al/media/333404/part_d-sut_compilation_albania.pdf

Klasifikimet e përdorura në Llogaritë Kombëtare janë: Nomenklatura e veprimtarive ekonomike (NVE Rev,2); Nomenklatura e produkteve (NP 2008); Klasifikimi i konsumit individual sipas përdorimit (COICOP); Klasifikimi i shpenzimeve të qeverisë sipas funksionit (COFOG).

Burimet e të dhënave

Për vlerësimet e TBP-ve përdoret informacioni i siguruar nga burime të ndryshme statistikore dhe administrative. Të dhënat e përdorura mund të jenë prodhim statistikor i vetë INSTAT ose i institucioneve të ndryshme kombëtare si Ministritë, Drejtoritë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Doganave, Qendra Kombëtare e Regjistrimit, Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore etj. Duke krahasuar këto burime me njëra-tjetrën, arrihet të prodhohet një pamje e vetme e ekonomisë, e cila është gjithëpërfshirëse, koherente dhe tërësisht e integruar.

Burimet statistikore përfshijnë të dhënat e siguruar nga regjistrime dhe anketa të ndryshme mbi njësitë ekonomike ose familjet, ndër të cilat mund të përmendim: Regjistri i Ndërmarrjeve; Anketa Strukturore pranë Ndërmarrjeve; Anketa e Tregtisë me Pakicë; Anketa e Buxhetit të Familjeve; Anketa të Statistikave të Çmimeve, Statistika të bujqësisë dhe mjedisit, etj.

Burimet administrative përfshijnë të dhëna administrative të mbledhura nga institucione të tjera për qëllime të ndryshme, ndër të cilat mund të përmendim: Pasqyrat financiare vjetore; Tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH); Bilanci i Pagesave; Statistika fiskale të administratës publike; Statistika të tregtisë së jashtme; Libri i shitjeve dhe i blerjeve etj.

Procesi i Balancimit

Procesi i balancimit është një proces shumë i rëndësishëm në tabelat e burim – përdorimeve. Pasi është bërë një përpunim i detajuar për secilin komponent duhet që gjithë burimet e një vendi të shkojnë si përdorime nga ana tjetër. Në shumicën e rasteve, kjo mund të mos arrihet që në hapin e parë të përdorimit të informacionit, për këtë arsye analiza zhvillohet mbi çdo produkt në këtë sistem.

Përpara se të shikohet mospërputhja në nivel produkti, analizohet mospërputhja statistikore që ekziston ndërmjet metodave të ndryshme të vlerësimit të PBB-së. Në sistemin e tabelave të burim-përdorimeve kjo mospërputhje statistikore eliminohet, si rrjedhim kërkohet që të arrihet ky balancim makroekonomik.

Në rastet kur diferenca ndërmjet burimeve dhe përdorimeve është më e vogël se 5,0 %, përdoret një balancim automatik i mbështetur mbi shpërndarjen në formë raporti të diferencës ekzistuese. Kur kjo diferencë është ndërmjet 5% dhe 10%, mund të mbështetemi mbi një analizë dhe balancim manual të diferencave. Në rastet kur kjo diferencë është më e madhe se 10 %, atëherë jemi në një situatë, e cila kërkon trajtim në burimin bazë të informacionit. Në këto raste mund të jetë e nevojshme që komponentë të ndryshëm të burimeve apo përdorimeve të kërkojnë një rivlerësim, i cili do të sillte një cikël rrethor të vlerësimeve. Ky cikël do të vazhdojë derisa të gjitha diferencat të jenë brenda intervaleve të pranueshme duke na mundësuar një konsistencë të plotë të vlerësimeve të PBB-së me metoda të ndryshme.

Përkufizime

Tabelat e Burimeve dhe Përdorimeve me çmime korrente: Sistemi i TBP-ve me çmime korrente në Shqipëri është i ndërtuar në nivel produktesh dhe aktiviteteve që korrespondojnë me NVE Rev, 2 dy shifrore. Analizat janë zhvilluar në nivel produkti sipas klasifikimit NP 2008 2, 4 dhe 6 shifrore, duke mundësuar në këtë mënyrë një pamje të qartë të qarkullimit të produktit në ekonomi. Për ndërtimin e TBP-ve në Shqipëri janë kryer një sërë analizash dhe studimesh për të mundësuar një përdorim sa më eficient të burimeve administrative dhe statistikore. Fokus i veçantë i është vënë kryesisht nivelit të detajimit të të dhënave për të kaluar në një detajim sa më të madh të mundshëm.

Prodhimi: Aktivitet i ushtruar nën kontrollin dhe përgjegjësinë e një njësie institucionale që kombinon burimet në fuqi punëtore, kapital dhe produkte të shërbimeve për të prodhuar produkte ose kryer shërbime. Proceset e pastra natyrore pa ndërhyrjen ose kontrollin e njeriut nuk bëjnë pjesë në prodhim.

Konsumi ndërmjetës: Vlera e produkteve ose shërbimeve të transformuara ose plotësisht të konsumuara gjatë procesit të prodhimit. Përdorimi i aktiveve fikse të vëna në punë nuk merret parasysh; ai evidentohet në konsumin e kapitalit fiks.

Taksat mbi produktet dhe importin: Taksat mbi produkte janë taksat e pagueshme për njësi të disa mallrave dhe shërbimeve si Taksa mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), akciza, taksa doganore mbi importet.

Subvencione në produkte: Subvencionet në produkte janë pagesat e pakthyeshme që njësitë e administratës publike bëjnë tek ndërmarrjet si një shumë e caktuar parash për njësi të një malli ose shërbimi. Subvencionet në importe konsistojnë në subvencionimin e mallrave ose shërbimeve që bëhen të pagueshme kur malli kapërcen kufirin e territorit ekonomik ose kur shërbimet i janë kaluar njësive institucionale rezidente.

Konsumi Final: Konsumi Final është një nga komponentët kryesorë të PBB, Ky konsiston në mallrat dhe shërbimet e përdorura nga familjet individuale ose komunitetet dhe llogaritet si shumë e konsumit final të familjeve, konsumit final të administratës publike dhe konsumit final të Institucioneve Jo Fitimprurëse që i Shërbejnë Familjeve (IJFSHs).

Konsumi final i familjeve: Llogarit të gjitha mallrat dhe shërbimet që përdoren direkt për të plotësuar kërkesat individuale të familjeve rezidente.

Konsumi final i administratës publike dhe Institucioneve jo fitim prurëse: Përmban vlerën e shërbimeve jotregtare të kryera nga administrata publike dhe nga institucionet jofitimprurëse në përfitim të komuniteteve ose grupe familjesh. Kjo llogaritet si diferencë midis prodhimit të administratës publike dhe IJFSHs dhe vlerës së prodhimit tregtar.

Eksporti neto: Eksporti neto llogaritet si diferencë midis eksportit të mallrave dhe shërbimeve (fob) dhe importit të mallrave dhe shërbimeve (fob).

Importi i të mirave materiale dhe shërbimeve konsiston në vlerën e transaksioneve në të mira materiale dhe shërbime të rezidentëve me jo-rezidentët.

Formimi Bruto i Kapitalit Fiks: Konsiston në shpenzimet e kryera për kapitale të reja ose për shpenzime të tjera specifike kryer nga prodhuesit në sende ose shërbime me qëllim që të mbajnë, rritin ose zgjerojnë kapacitetin e tyre prodhues ose që të krijojnë kushte të reja përpunimi në të ardhmen.

Ndryshimi i gjendjeve: Përcaktohet si diferencë midis gjendjeve të inventarit dhe në proces të aktiveve qarkulluese në fund dhe në fillim të vitit, Gjendjet përfshijnë: materiale të para dhe materiale të tjera; prodhime, punime shërbime në proces; produkte të gatshme e gjysmë të gatshme, mallra, kafshë, etj.

Marzhi Tregtar përcaktohet si diferencë midis çmimit aktual ose të imputuar të një produkti të blerë për rishitje, dhe çmimit që do të paguhej për zëvendësimin e produktit në momentin e shitjes.

Marzhi i Transportit përfshin koston e transportit të paguar më vete nga blerësi të përfshira në përdorimet me çmime të blerësit, por jo në prodhimin e prodhuesit me çmime bazë apo në marzhin tregtar.

Çmime bazë: Shuma që prodhuesi merr nga blerësi për njësi të produktit apo shërbimit të prodhuar, pa tatimet dhe subvencionet mbi produktin, Çmimi bazë përjashton shpenzimet e transportit të faturuara më vete.

Çmimet e tregut: janë çmimet pasi shtohen taksat mbi produktet minus subvencionet mbi produktet.

Çmime korrente: Çmimet e periudhës referuese, Ato përfaqësojnë çmimin e paguar për të mirat materiale dhe shërbimet në kohën e prodhimit ose të konsumit.

Çmimet konstante: Vlerësimet me çmime konstante janë në vlerë realë, që do të thotë se ato janë përshtatur për ndryshimet e çmimeve në raport me një vit bazë. Ato janë një mënyrë për të matur ndryshimin real në prodhim.

Kompensimi i punonjësve: Përcaktohet si shpërblimi total, në para ose në natyrë, që një punëdhënës i paguan një punonjësi në këmbim të punës së kryer gjatë periudhës së kontabilitetit. Kompensimi i punonjësve përfshin pagat dhe kontributet sociale të punëdhënësit.

Teprica operative bruto (B.2g): Kjo është diferenca që mbetet pas zbritjes nga vlera e shtuar bruto (me çmimet bazë) të kompensimit të punonjësve dhe taksave dhe subvencioneve të tjera mbi prodhimin. Fitimi operativ i të vetëpunësuarve quhet "Të ardhura të përziera bruto (B.3g)" sepse përfshin gjithashtu kompensimin për punën e individëve të vetëpunësuar dhe anëtarëve të familjes së tyre.